



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0815

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim – kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi – anëtar të panelit shqyrtues, duke vendosur sipas ankesës së OE “Valdrini” Sh.P.K. kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha ritender” me numër të prokurimit 616-23-10571-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, me datë 05.11.2024 mori:

Vendim

1. Aprovohet sie pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Valdrini” Sh.P.K. kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha ritender” me numër të prokurimit 616-23-10571-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 27.08.2024.
3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 02.10.2023 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha ritender” me numër të prokurimit 616-23-10571-5-1-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë, me vlerë të parashikuar 1,100,000.00€.

Me datë 27.08.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë GOE “Flamuri V Sh.P.K. & Benita Company Sh.P.K”.

Me datë 02.09.2024, operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 04.09.2024.

Me datë 09.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0815.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues:

Pretendimi 1: *“Ne jemi eliminuar me arsyetimin se për inxhinierin e ndërtimtarisë-gjeodezi me 5 cite përvojë pune pas diplomimit, ku kemi ofruar si staf inxhinierin L.A. dhe se për të njëjtin nuk janë dorëzuar kontratat e punës apo vërtetimet e ATK-së – lista e pagave dhe se nuk është ofruar as diploma bachelor por vetëm ajo master”.*

Pretendimi 2: *“Jemi eliminuar edhe me arsyetimin se CV e inxhinierit F.K. nuk i përmbushë kërkesat minimale sipas dosjes së tenderit sepse është vështirë të kuptohet se CV e kujt është sepse nuk figuron as emri i personit për të cilin është dorëzuar CV-ja”.*

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 23.09.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Lidhur me pretendimin e parë - *“Eksperti shqyrtues sqaron se pas pretendimit në ngritur ka analizuar dokumentet për inxhinierin e lartpërmendur sa i përket dëshmive të ofruara për përvojën e punës dhe diplomën. OE ankues në ofertën e tij për inxhinierin L.A. ka ofruar diplomën master, studimet të cilat kanë përfunduar në vitin 2013 por sipas AK-së i njëjti është dashur të dorëzoj edhe diplomën bachelor. Sipas ekspertit arsyeja e vetme e cila nevojitet për dorëzimin e diplomës bachelor në rastin konkret është vetëm kalkulimi i përvojës së punës pas diplomimit e cila ka mund të kërkohet përmes nenit 72 të LPP-së, pasi që është një dokument ekzistenca e të cilit është lehtë e verifikueshme, për më tepër në rastin se inxhinieri në fjalë*

përmbush kushtin e pesë viteve përvojë pune të kërkuara edhe nga kalkulimi i përfundimit të studimeve të diplomës së dorëzuar, atëherë përsëri dorëzimi i diplomës së studimeve themelore nuk është relevante në atë rast. Eksperti gjithashtu ka analizuar edhe dokumentet e tjera të kërkuara si dëshmi për përvojën e punës. Në ofertë është parë se përvec CV-së, licencave dhe diplomës janë ofruar edhe disa referenca të lëshuara nga organizata të ndryshme por në të cilat nuk shihen qartë periudhat e angazhimit. AK ka eliminuar operatorin ankues pa i sqaruar fare këto pika sipas ligjit për prokurimin publik. Me kërkesën për rishqyrtim dhe me ankesën në OSHP, OE ankues ka bashkangjitur edhe trustin pensional për inxhinierin L.A. në të cilin dokument shihet se inxhinieri në fjalë ka përvojë pune mbi vitet minimale të kërkuara, sipas ekspertit vërtetimi nga trusti pensional është dokument i lëshuar nga institucioni i shtetit i cili është ekuivalent me deklaratat e kërkuara nga ATK. Për më tepër institucionet nga të cilat janë paguar kontributet e inxhinierit përkojnë me ato të paraqitura në CV-në e dorëzuar në ofertë, ku i njëjti deklaroi se ka qenë i angazhuar si ekspert i gjeodezisë në sektorin privat dhe një gjë e tillë vërtetohet edhe me trust, andaj vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i bazuar”.

Lidhur me pretendimin e dytë - *“Sa i përket këtij pretendimi eksperti pasqyron që pjesa e CV-së është e një formati të caktuar e cila ndryshon nga formatet e zakonshme, megjithatë në këtë CV është paraqitur përvoja e punës, duke përfshirë datat, vendin, ndërmarrjen, pozitën e punës dhe llojin e detyrave. Duke marrë parasysh se CV e inxhinierit F.K. ndodhet në folderin me emrin e inxhinierit në të cilin janë dorëzuar vetëm dokumentet e inxhinierit të njëjtë përfshirë diplomën, parakontratën e punës, referencat, certifikatat dhe trustin pensional atëherë sipas ekspertit edhe pse në fillim të CV-së nuk shkruan emri i inxhinierit, është më se e qartë se kujt i takon CV-ja e dorëzuar dhe konsiderojmë që pretendimi i ngritur nga operatori ankues është i bazuar”.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues ku mos pajtimin e ka derguar përmes e-mailit të OSHP-se, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë ku me ftesë të panelit shqyrtues pjesëmarrës në seance dëgjimore me datën 30.10.2024 ishin të pranishëm përfaqësuesit e AK-së, OE ankues, eksperti shqyrtues, dhe monitorues nga organizatat joqeveritare (Demokracia Plus, dhe GLPS).

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë nuk janë të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankues, për shkak se ka dallime në përgjigje të pretendimeve ankimore ndaj arsyeve për të cilat është eliminuar ankuesi dhe nuk ka një pasqyrim të qartë të gjendjes reale.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave

tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues ka gjetur se OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit si ofertues i papërgjegjshëm me arsyetimin e prezantuar në letrën standarde për tenderues të eliminuar si vijon:

“1.Sa i përket kërkesës së DT “Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Gjeodezisë 5 vite përvorje pune pas diplomimit”, GOE ka përcaktuar z. L.A . Fillimisht duhet sqaruar se sipas kësaj pike të kërkesës në fjalë të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvorje të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvorja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar as kontrata të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z.L.A) ka së paku pesë (5) vite përvorje të punës pas diplomimit dhe as vërtetimet nga ATK - Listat e pagave. Sa i përket parakontratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo kontratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përvorjës së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë kjo parakontratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Përderisa nuk janë dorëzuar as kontratat e punës dhe as vërtetimet përkatëse nga ATK, nuk është arritur që të dëshmohet përvorja e punës pas diplomimit për personin në fjalë. Vlen të thuhet po ashtu se as përmes ofertës mirëpo as përmes sqarimeve shtesë nuk është dorëzuar diploma bachelor (studimet themelore) për inxhinierin e gjeodezisë z. L.A. Në vend të kësaj është dorëzuar diploma e studimeve master megjithatë është dashur patjetër që të dorëzohet edhe diploma e studimeve bachelor pasi që e njëjta është kërkuar edhe përmes dosjes së tenderit ku askund nuk përmendet diploma master. Rrjedhimisht GOE nuk ka arritur që të përmbushë këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Mbi të gjitha vlen të theksohet fakti që as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit përderisa në kërkesën për rishqyrtim nuk e kundërshton të gjeturën e komisionit vlerësues si të tillë por vetëm thotë se përvorjen e punës personi në fjalë e ka dëshmuar përmes CV dhe AK ka pasur për detyrim që të kërkoj sqarime shtesë. Sa i përket CV, kërkesa e DT ka qenë shumë e kjartë dhe nuk duhet të ekzistoj asnjë dilemë për dëshminë dokumentare që është kërkuar për të dëshmuar përvorjen e punës. Parashtruesi ka pasur mundësi që të kundërshtoj kërkesat e dosjes së tenderit para hapjes së ofertave. Prandaj në këtë fazë nuk ka mundësi dhe as të drejtë që dikush të interpretoj ndryshe kërkesat e tenderit apo të ndryshoj ato. Ngjashëm vlen edhe për pjesën ku thuhet se përvorja e punës ka mundur të dëshmohet me trust pensional. Kjo nuk qëndron pasi që është në

kundërshtim me dëshminë dokumentare të kërkuar me DT. Nëse parashtruesit i mundësohet që të dëshmoj përvojën e punës me CV apo me trust, është dashur që të shkruhet në DT dhe kjo të vlejë për të gjithë operatorët njësoj. Në të kundërtën do të ishte diskriminuese për tenderuesit e tjerë dhe favorizuese vetëm për parashtruesin. Ndërsa sa i përket pretendimit për sqarime, duhet shtuar se AK nuk ka për detyrim që të kërkoj sqarime për secilin gabim që mund të bëj një operator ekonomik me rastin e dorëzimit të ofertës. Sqarimet kërkohen atëherë kur dorëzohet një dokument i caktuar dhe lidhur me atë dokument AK ka dilema të caktuara apo ka nevojë për sqarime shtesë. Në rastin konkret parashtruesi nuk ka dorëzuar fare dëshmitë e kërkuara dokumentare dhe ka qenë e pamundur që të kërkohen sqarime pasi që kjo do të përbënte ndryshim material rrënjësor të ofertës.

2. Nga administrimi me ofertën e parashtruesit është gjetur se CV e inxhinierit F. Kr nuk i përmbush kërkesat minimale sipas dosjes së tenderit. Në fakt po të analizohet CV si e vetme, është shumë e vështirë që të kuptohet se CV e kujt është sepse aty nuk figuron as emri i personit për të cilin është dorëzuar CV. Si e tillë CV më shumë i përngjan një liste të projekteve kur pretendohet se ka marrë pjesë personi në fjalë sesa një CV me të dhënat bazike të një biografike standarde. Prandaj në kuptim të Udhezuesit per Prokurim Publik lidhur me nenin 69 të LPP ku përcaktohet se kur “CV nuk përmbush kërkesat – Refuzo tenderin pa kërkuar informacione mëtejshëm”. Vlen të shtohet se këtë fakt GOE nuk e ka kontestuar fare me kërkesën për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të parë.

3. Lidhur me kërkesën e DT “Një (1) menaxher i projektit - inxhinier i ndërtimitarisë në drejtimin konstruktive, me së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit”, ju keni përcaktuar z. H.K. Bazuar në diplomën e dorëzuar për menaxherin e projektit – inxhinierin e ndërtimitarisë, është gjetur se i njëjti ka diplomuar dhe ka marrë titullin “Inxhinier i diplomuar i ndërtimitarisë” me datë 09.03.2022. Ky fakt është provuar përmes kopjes së noterizuar të diplomës. Sipas dosjes së tenderit është kërkuar që menaxheri i projektit të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë të punës profesionale pas datës së diplomimit. Duke marrë parasysh faktin që njoftimi për kontratë është publikuar në tetor të vitit 2023, rezulton se menaxheri i projektit i cili duhet të jetë edhe inxhinier i ndërtimit – drejtimi konstruktiv nuk e përmbushë kërkesën për përvojë të punës prej shtatë (7) viteve pas datës së diplomimit. Duhet cekur faktin që në diplomën e menaxherit potencohet që i njëjti ka regjistruar studimet në vitin 2001 ndërsa ka përfunduar provimet në vitin 2006, mirëpo nuk ka arritur të diplomoj deri në vitin 2022. Periudha kur janë regjistruar dhe kur janë përfunduar provimet (2001 deri 2006) korespondojnë edhe me datat që janë evidentuar në CV të menaxherit. Mirëpo duhet pasur parasysh që përmes dosjes së tenderit janë kërkuar shtatë (7) vite përvojë të punës profesionale pas datës së diplomimit. Pra nuk është fare relevante nëse ndërmjet datës kur janë përfunduar provimet dhe datës së diplomimit ekziston një hapësirë e konsiderueshme kohore (si në rastin konkret). Për këtë aktivitet të prokurimit duke marrë parasysh dosjen e tenderit është relevante vetëm data e diplomimit (09.03.2022). Komisioni vlerësues ka verifikuar nëse diploma në rastin konkret është diplomë dublikat mirëpo me këtë rast ka gjetur se se në dokumentin në fjalë (në diplomë) nuk përmendet fare fjala “duplikat” ngjashëm sikurse nuk përmendet kjo fjalë as në vërtetimin e noterit që është dorëzuar lidhur me këtë diplomë. Në anën tjetër as GOE nuk ka dorëzuar asnjëherë një vërtetim përmes të cilës do të mund të konfirmohet një fakt i tillë. Vlen të shtohet se të gjitha të gjeturat më sipër janë në përputhje të plotë me vendimin e Panelit Shqyrtues OSHP:2024/0438 të datës 15.07.2024 ku në faqen 5 te pjesa e të gjeturave të panelit shqyrtues thuhet se “Për H.K., vlerësohet se data e diplomimit është kritike për vërtetimin e përvojës së tij...”. Në rastin konkret data e diplomimit respektivisht data 09.03.2022 është marrë si datë kritike sipas të cilës nuk është arritur që të përmbushet kërkesa në fjalë e dosjes së tenderit.

4. Lidhur me kërkesën e DT “Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve 5 vite përvore pune pas diplomimit”, GOE ka përcaktuar z. F. Kr. Fillimisht duhet sqaruar se sipas kësaj kërkesë të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvore të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvoreja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar kontrata të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z. F. K) ka së paku pesë (5) vite përvore të punës pas diplomimit. Sa i përket parakontratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo kontratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përvores së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë kjo parakontratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Sa i përket dëshmisë mbi pesë (5) vite të përvores së punës pas diplomimit, janë dorëzuar edhe disa vërtetime nga ATK për vitet 2018-2023. Në fakt këto vërtetime nuk janë dorëzuar përmes ofertës por janë dorëzuar vetëm pas sqarime shtesë të datës 20.11.2023 të kërkuara nga autoriteti kontraktues. Mirëpo pas analizimit të këtyre vërtetimeve është gjetur si vijon:

- z.F.K nuk figuron fare në listën e punëtorëve në vërtetimin e ATK për vitin 2018 dhe për vitin 2019.
- I njëjti është evidentuar si punonjës vetëm në vërtetimin e ATK të vitit 2020 ku përcaktohet se personi në fjalë (z. F.K) gjatë vitit 2020 i ka vetëm tetë (8) muaj të përvores së punës konkretisht nga muaji i pestë (5) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tutje në vitin 2021 personi në fjalë sipas vërtetimit të ATK figuron se gjatë vitit 2021 i ka vetëm njëmbëdhjetë (11) muaj të përvores së punës konkretisht nga muaji i dytë (2) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tutje në vitin 2022 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. F. K. i ka dymbëdhjetë (12) muaj të përvores së punës respektivisht vitin e plotë.
- Ndërsa në vitin 2023 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka nëntë (9) muaj të përvores së punës konkretisht nga muaji i parë (1) deri te muaji i nëntë (9).

Nga sa u tha më sipër përmes vërtetimeve të ATK (listës së pagave) të dorëzuara nga GOE është konstatuar se Inxhinjeri z. F. K. i ka vetëm dyzet (40) muaj përvore të punës. Në anën tjetër përmes dosjes së tenderit janë kërkuar së paku pesë (5) vite apo gjashtëdhjetë (60) muaj të përvores së punës pas diplomimit. Bazuar në dokumentet që janë dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar përmes ofertës por edhe në dokumentet shtesë të dorëzuara si sqarime me datë 20.11.2023, tenderuesi i rekomanduar për këtë pikë të kërkesës (inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv) nuk ka arritur të dëshmojë se z. Faruk Kryeziu i ka së paku pesë (5) vite të përvores së punës pas diplomimit. Kjo pasi që nuk janë dorëzuar kontratat me punëdhënësit me të cilët është zhvilluar kjo marrëdhënie e punës sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Në anën tjetër as përmes vërtetimeve nga ATK – listave të pagave nuk është vërtetuar se personi në fjalë e ka pëmbushur kërkesën e përvores së punës prej pesë (5) viteve. Lidhur me personin në fjalë (z. F. K) janë dorëzuar edhe disa dokumente shtesë (referenca, deklarata, etj) të cilat nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit dhe si të tilla nuk mund të

manifestojnë asnjë ndikim mbi vlerësimin përfundimtar të ofertës përkatëse.

Vlen të shtohet se Paneli Shqyrtues përmes vendimit OSHP:2024/0438 të datës 15.07.2024 në faqe nr. 5 të pjesa e të gjeturave të Panelit Shqyrtues ka konstatuar se “për F.K., dëshmia e përvojës nga trusti pensional u pranua si e vlefshme, treguar përvojë mbi 5 vite.” GOE në ankesën e vet në OSHP ka konfirmuar se nuk ka dorëzuar kontratat e punës, ose vërtetimet e ATK mirëpo ka kërkuar që pagesat e trustit pensional t’i pranohet si ekuivalente. Në këtë rast nuk ka elaboruar se pagesat e trustit pensional nuk janë bërë për punën profesionale që ka realizuar z.F. K si inxhinier pas diplomimit por janë realizuar nga një biznes ku vet Faruk Kryeziu ka qenë pronar (pra nuk bëhet fjalë për përvojë të punës profesionale si inxhinier por si pronar i biznesit të tij). Aq më pak nuk ka potencuar që biznesi në fjalë ku ka qenë pronar z.F. K nuk është pjesë e konzorciumit (GOE) që ka ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Këtë fakt GOE e ka elaboruar pikërisht në kërkesën për rishqyrtim të datës 05.05.2024. Rrjedhimisht edhe vet Paneli Shqyrtues është vënë në lajthim nga mënyrë e formulimit të pretendimit ankimor. Përndryshe sa i përket faktit se personi në fjalë ka një biznes të tij privat për të cilin ka paguar tatime – trustin pensional, duhet cekur se në kërkesën e dosjes së tenderit është kërkuar që inxhinieri të ketë përvojë të punës profesionale si inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, apo ndërtimi i rrugëve dhe jo përvojë si pronar i biznesit apo përvojë tjetër. Në rastin konkret komisioni ka nxjerrë konstatimin nga vlerësimi i atyre dokumenteve me të cilat ka ofertuar vet parashtruesi. Komisioni as nuk mundet dhe as duhet që të vlerësoj mbi bazën e dokumenteve që nuk janë pjesë e ofertës së parashtruesit. Prandaj mbi bazën e atyre vërtetimeve tatimore që parashtruesi ka dorëzuar është gjetur se personi në fjalë gjatë viteve 2018-2023 i ka vetëm 40 muaj përvojë të punës profesionale dhe nuk i ka 60 muaj përkatësisht 5 vite sikurse është kërkuar me dosje të tenderit. Duke qenë pronar i një biznesi, përvoja e Faruk Kryeziut nuk është përvojë profesionale e tij si inxhinier por është përvojë si ndërmarrës. Për më tepër biznesi në fjalë nuk është fare pjesë e GOE që ka ofertuar në këtë AP. Prandaj GOE nuk ka arritur që të përmbushë as këtë kërkesë të DT”.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit Paneli Shqyrtues me datë 15.07.2024 ka marrë vendimin OSHP:2024/0438 përmes të cilave ka trajtuar pretendimet ankimore të OE ankues lidhur me aktivitetin e njëjtë të prokurimit. Përmes vendimit OSHP:2024/0438 aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim. Përmes ankesës 2024/0815 OE ankues ka përsëritur të gjitha pretendimet ankimore mirëpo njëkohësisht ka shtuar edhe dy pretendime të reja të cilat janë shqyrtuar përmes këtij vendimi. Prandaj Paneli Shqyrtues pretendimet e trajtuara përmes vendimit OSHP:2024/0438 i trajton si çështje të gjykuar (res judicata). Rrjedhimisht objekt i këtij vendimi janë vetëm dy pretendimet e reja që nuk janë trajtuar deri më tani nga OSHP.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin e parë ankimor të OE ankues i referohet arsyes së parë eliminuese, ka gjetur se në dosjen e tenderit është kërkuar një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Gjeodezisë 5 vite përvojë pune pas diplomimit ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvoja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në ofertën e tij OE ankues për inxhinierin L.A. nuk ka dorëzuar as kontratat e punës dhe as vërtetimet përkatëse nga ATK. Në vend të tyre ka dorëzuar disa deklarime të inxhinierit në trust. Po ashtu OE ankues për inxhinierin L.A. nuk ka dorëzuar diplomën e studimeve bachelor por vetëm diplomën e studimeve master, ndërsa ne NJT dhe DT është kërkuar inxhinjer . OE ankues as përmes ofertës mirëpo as edhe përmes kërkesës për ri-shqyrtim , sqarimeve shtesë të kërkuara nga AK nuk e ka dorëzuar diplomën bachelor (studimet themelore) për inxhinierin. Paneli Shqyrtues konsideron se kërkesa e DT ka qenë shumë e kthjellë dhe nuk duhet të ekzistoj asnjë dilemë për dëshminë dokumentare që është

kërkuar për të dëshmuar përvojën e punës. OE ankues ka pasur mundësi që të kundërshtoj kërkesat e dosjes së tenderit para hapjes së ofertave. Prandaj në këtë fazë nuk ka mundësi dhe as të drejtë që dikush të interpretoj ndryshe kërkesat e tenderit apo të ndryshoj ato. Pra paneli shqyrtues nuk pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues ku thuhet se mungesa e kontratës së punës apo vërtetimit nga AK mund të zëvendësohet me CV e inxhinierit pasi që një interpretim i tillë është në kundërshtim me nenin 7 të LPP. Ngjashëm vlen edhe përvojën e punës ku eksperti thotë se ka mundur të dëshmohet me trust pensional. As ky konstatim nuk qëndron pasi që është në kundërshtim me dëshminë dokumentare të kërkuar me DT. Nëse parashtruesit i mundësohet që të dëshmoj përvojën e punës me CV apo me trust, është dashur që kjo të kërkohej specifikisht në DT dhe kjo të vlejë për të gjithë operatorët njësoj. Në të kundërtën do të ishte diskriminuese për tenderuesit e tjerë dhe favorizuese vetëm për një OE. Rrjedhimisht paneli shqyrtues ka gjetur se OE ankues nuk ka arritur që të përmbushë këtë kërkesë të DT dhe këto kontrata kanë qenë kërkesë eksplicite e DT, me çrast ankuesi nuk e dëshmon as në ofertën e tij, as në kërkesë për rishqyrtim dhe as në ankesë në OSHP, edhe pas përsëritjes së kësaj ankese për herën e dytë, kështu që, për këtë arsye Paneli nuk i ka falur besimin konstatimit të ekspertit ndërsa pretendimin ankimor e ka gjetur si të pabazuar.

Lidhur me pretendimi i dytë ankimortë OE ankues i referohet arsyes së dytë eliminuese. Paneli Shqyrtues konsideron nuk është kontestues fakti që në CV e inxhinierit F.K. mungojnë disa elemente sikurse emri i personit për të cilin dedikohet CV-ja, pastaj rubrika bazike e CV për biografinë standarde etj, edhe Referencat nga OE privat te paraqitura për këtë inxhinjer si punëdhënës të lëshuara nga N.N.SHKËMBI , NN..P ‘‘NDERTIMI’ SKENDERAJ; B CORRP SH.P.K , nuk jane fare te pershkruara ne CV si pervoj pune tek kto kompanit , po as edhe të dokumentuara në trustin e ofruar për këtë inxhinjer, apo ndonje dëshmi tjetër me ndonje qarkullim bankar. Ky fakt nuk kontestohet as nga eksperti shqyrtues. Vlen të shtohet se këtë fakt as OE ankues vet nuk e ka kontestuar fare me kërkesën për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të parë. Sipas pikës 10 të UPP lidhur me nenin 69 të LPP përcaktohet që “kur CV nuk përmbush kërkesat – refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimi i dytë ankimor është i pabazuar dhe nuk i ka falur besimin ekspertit shqyrtues, por e mbështet arsyetimin e AK, ku është kërkuar që inxhinieri të ketë përvojë të punës profesionale si inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv apo ndërtimi i rrugëve dhe jo përvojë si pronar i biznesit apo përvojë tjetër. Prandaj mbi bazën e atyre vërtetimeve tatimore që parashtruesi ka dorëzuar është gjetur se personi në fjalë gjatë viteve 2018-2023 i ka vetëm 40 muaj përvojë të punës profesionale dhe nuk i ka 60 muaj përkatësisht 5 vite sikurse është kërkuar me dosje të tenderit. Duke qenë pronar i një biznesi, përvoja e inxhinjerit F.K nuk është përvojë profesionale e tij si inxhinier por është përvojë si ndërmarrës. Për më tepër biznesi në fjalë nuk është fare pjesë e GOE që ka ofertuar në këtë AP. Prandaj GOE nuk ka arritur që të përmbushë as këtë kërkesë të DT.

Lidhur me nenin 6 të LPP për të cilën ekspertja shqyrtues ju është referuar, ky Panel Shqyrtues konsideron se ekspertja shqyrtues në momentin që ka përmend këtë dispozitë ligjore, ka qenë dashtë të ofroj një sqarim më në detaje dhe të ndalet më tepër tek çmimi i ofertuesëve e konkretisht i ankuesit sepse ka një disproporcion të madh me çmimet e ofertuesëve tjerë dhe me vlerën e parashikuar dhe është edhe një ofertë tjetër e përfshirë që ka tejkallim te buxhetit prej 637,555.82, edhe OE e rekomanduar që kanë bërë tejkallim të vlerës së parashikuar, dhe për të cilën gjate seances degjimore të dates 30.10.2024 , PSH ka parashtruar pyetje nga perfaqsesit te AK-se duke kerkuar konfirmim se OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar çmimin mbi vleren e parashikaur dhe a keni konfirmim qe keni mundësin e shtimit te mjeteve nga ZKF ku në seance degjimore u konfirmuar që ZFK -ja dhe ZKA pranë AK ka pranuar këtë tejkallim duke

shtuar buxhetin lidhur me këtë projekt .

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet por vetëm si pjesërisht e bazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 27.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha ritender” me numër të prokurimit 616-23-10571-5-1-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsye të elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,6,7,27,28 dhe 56 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tenderë që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë. Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me “kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit” për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre. Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar.

Rrjedhimisht, PSH vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe përgjegjës konform nenit 59 par. 1 të LPP-së. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduara për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Paneli Shqyrtues gjithashtu thekson rëndësinë e përmbushjes së kushteve formale dhe të përgjegjshme nga të gjithë ofertuesit në procesin e tenderimit. Në këtë kontekst, është thelbësore që çdo ofertues të veprojë sipas parimit të kujdesit dhe të kontrollojë të tërë dokumentacionin, duke siguruar që të gjitha dokumentet e nevojshme të jenë të sakta dhe të plota, për të shmangur çdo situatë të ngjashme që mund të dëmtojë reputacionin e tyre dhe të ndikojë në rezultatet e

procesit të tenderimit. Për këtë është deklaruar edhe në Formularin e Dorëzimit të Tenderit, të cilin e ka ofruar me ofertën e tij në këtë tenderim.

Andaj, Paneli Shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues kishte të drejtë të vepronte siç e bëri, duke refuzuar tenderin në bazë të dokumentacionit të papërshtatshëm të ofruar nga OE ankues. Ky vendim mbështetet në kërkesat ligjore dhe rregullat e përcaktuara për prokurim publik, si dhe në parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës që duhet të karakterizojnë çdo procedurë të tillë.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Valdrini sh.p.k**
- Arkivës së OSHP-së: